



REPUBLIKA E SHQIPERISE

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
ZËVENDËSREKTORI

Nr. 1233/Prot.

Tiranë, më 19/08 2025

Lënda: Përcjellje informacioni.

Znj. Xh. [REDACTED] S. [REDACTED]

Për dijeni:

Prof. Dr. Erald Bakalli
Rektori i Universitetit të Arteve

E nderuara znj. S. [REDACTED],

Në përgjigje të kërkesës suaj dërguar Universitetit të Arteve me datë 07/07/2025 ju informojmë se Universiteti ynë, si një institucion publik i arsimit të lartë me veprimtari në fushën e arteve, nuk boton në mënyrë specifike një buletin shkencor, as në kuadër të universitetit dhe as në kuadër të fakulteteve përbërëse të tij. Por, në faqen e tij zyrtare, janë hedhur të gjitha të dhënat mbi Konferencën e Parë Ndërkombëtare Shkencore mbi Artet dhe Edukimin, përfshirë edhe Book of Abstracts, me synimin që në të ardhmen, të arrijmë të botojmë edhe punime të tjera shkencore përfshirë dhe buletin shkencor të universitetit.

<http://uart.edu.al/index.php?id=1368>

Ju falënderoj për mirëkuptimin..

ZËVENDËSREKTORI

Prof. Arian Paco